



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:085125  
Datë: 03.05.2024  
Numri i dokumentit: 05655001

Pml.nr.274/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi kryetar i kolegjit, Mejreme Memaj dhe Valdete Daka, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit I. B., për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit av. Valon Sadiku, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan - Departamenti i Përgjithshëm, Pp.nr.12/2024 të datës 11.4.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1DP.nr.501/2024 të datës 17.4.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 3.5.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit I. B., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan - Departamenti i Përgjithshëm, Pp.nr.12/2024 të datës 11.4.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN1DP.nr.501/2024 të datës 17.4.2024.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin Pp.nr.12/2024 e datës 11.4.2024, të pandehurit I. B., për shkak të veprës penale

përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 2 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, nga data 12.4.2024 deri me datën 10.6.2024. Të pandehurit masa e paraburgimit i është vazhduar konform dispozitës së nenit 184 par. 1 nën par. 1.1 e 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Po ashtu është urdhëruar ekzaminimi psikiatrik për të pandehurin në Qendrën Klinike Universitare – Klinika e Psikiatrisë, Reparti i Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN1DP.nr.501/2024 të datës 17.4.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit av. Valon Sadiku, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësorë, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe t'i ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara ashtu që i pandehuri të mbrohet në liri apo t'i caktohet ndonjë masë më e butë.

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.119/2024 të datës 2.5.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të pandehurit, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë thekson gjykata e shkallës së dytë nuk kanë dhënë arsye të qëndrueshme dhe bindëse se vazhdimi i paraburgimit është masa e vetme me të cilën do të mund arrihej qëllimi i sigurimit të prezencës së të pandehurit në procedurën penale. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim lidhur me pretendimin ankimor të mbrojtjes lidhur me mos dërgimin e kërkesës së prokurorisë për vazhdimin e masës së paraburgimit mbrojtjes. Nuk ka rrezik të ikjes, fshehjes, ndryshimit të provave, pasi që provat i ka prokuroria. I pandehuri, dyshohet se ka probleme shëndetësore të natyrës psikike dhe kjo është hera e parë që i pandehuri bie ndesh me ligjin, andaj ndaj tij është dashur që të caktohet ndonjë masë alternative.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk janë të bazuara, nga se në rastin konkret, Gjykata e shkallës së parë ka urdhëruar institucionin përkatës për ekzaminimin psikiatrik të të pandehurit dhe është në pritje

të këtij raporti, dhe varësisht nga konstatimet dhe rekomandimet për gjendjen mendore të të pandehurit do të vendoset për rrjedhën e mëtejme të rastit konkret penal.

Pretendimi i mbrojtësit të të pandehurit lidhur me shkeljen e dispozitës së nenit 188 par. 2 të KPP, qëndron, por si e tillë nuk ka ndikim në mënyrën e vendosjes, për faktin se në rastin konkret, edhe po të ishte njoftuar mbrojtja tri ditë para skadimit të paraburgimit për propozimin për vazhdimin e kësaj mase nga ana e prokurorit, mbrojtja nuk ka mbledhur dhe nuk posedon ndonjë argument të tillë të pakontestueshëm (sepse po të kishte atë do ta prezantonte me këtë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë) dhe aq bindës që do të ndikonte në ndryshimin e gjendjes ekzistuese, andaj shkelja e tillë konstatohet, por nuk ka ndikim në mënyrën e vendosjes meritorë për rastin dhe të pandehurin dhe me të nuk vihet në dyshim drejtshmëria dhe ligjshmëria e aktvendimeve të kundërshtuara.

Pretendimet e mbrojtëses lidhur me ndryshimin e masës së paraburgimit me lënien në liri ose nën ndonjë masë më të butë alternative, nuk qëndrojnë ngase mbrojtësi ka qenë prezent në seancën dëgjimore ku në procesverbal është konstatuar se te i pandehuri vërehet se ka çrregullime mendore, po ashtu edhe në arsyetimin e aktvendimit të shkallës së parë ka theksuar se pritet që të bëhet raporti i ekzaminimit psikiatrik për të pandehurin, dhe se duhet që të pritet ekspertiza për gjendjen e shëndetit mendor të të pandehurit dhe varësisht nga konstatimet e atij raporti, do të vepohet dhe po qe se ka rrethana që tregojnë se kanë pushuar kushtet për vazhdimin e masës së paraburgimit gjykata do të veprojë konform nenit 182 par.3 të KPP, respektivisht të hiqet masa e paraburgimit dhe të lirohet i pandehuri në procedurë të rregullt.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa mbrojtja në liri apo nën ndonjë masë alternative, sipas propozimit të mbrojtësit të të pandehurit nuk qëndron, sepse vetëm pas rezultateve të ekzaminimeve mjekësore lidhur me gjendjen e tij psikike dhe mendore dhe varësisht nga gjetjet dhe rekomandimet e komisionit mjekësor, gjykata atëherë do të mund të vendosë lidhur me vazhdimin apo ndërprerjen e masës së paraburgimit dhe rrjedhës së mëtejme të procedurës penale lidhur me të pandehurin.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.274/2024, më 3.5.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,  
Agim Maliqi